



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET


“KOLEGJI BIZNESI”

dhe

“Albanian University”



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

MIDIS

KOLEGJI BIZNESI, person juridik, i regjistruar me MTI numër biznesi 810494542, i përfaqësuar nga **Prof. Dr. Shyqeri Kabashi**, Rektor i Institucionit.

dhe

UNIVERSITETIT "Albanian University", person juridik, i regjistruar në QKB me NIPT J82025002B, i përfaqësuar nga **Prof. Dr. Kaliopi Naska**, Rektor i Institucionit.

Palët bien dakort që të respektojnë dispozitat e kësaj marrëveshje të shprehura si më poshtë:

NENI 1

QËLLIMI I MARRËVESHJES

Qëllimi: Synimi i dy Institucioneve të Arsimit të Lartë për të bashkëpunuar, brenda kërkesave të tyre përkatëse ligjore dhe institucionale, planeve dhe qëllimeve strategjike, dhe disponueshmërisë së burimeve.

NENI 2

OBJEKTI I MARRËVESHJES

Objekti i kësaj marrëveshje është:

Bashkëpunimi mes dy institucioneve në organizimet e aktiviteteve akademike të përbashkëta, konferencave, shkëmbimin e stafit, studentëve, angazhimin në projekte dhe publikime të ndryshme që kanë në fokus kërkimin shkencor dhe shkëmbimin kulturor, në mënyrë që të forcojë dhe promovojë miqësinë e të dy palëve, kapacitetin në arsim, kërkim shkencor, dhe ndikimin e tyre si brenda vendit ashtu dhe jashtë tij.



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë



Mbi këtë frymë:

“Palët vendosën të krijojnë një lidhje zyrtare për të nxitur bashkëpunimin dypalësh në rang kombëtar dhe ndërkombëtar në arsim dhe jo vetëm, në mënyrë arritjen e rrugëve të suksesit në sektorë të ndryshëm, në shërbim të palëve të interesuara, bashkëpunëtorëve, studentëve, stafeve respektive të të dy institucioneve.”

NENI 3

Bashkëpunimi institucional ndërmjet Kolegjit BIZNESI dhe “Albanian University” synon:

- a. Pjesëmarrje në programe arsimore ndërkombëtare dhe projekte të përbashkëta të BE-së, të tilla si Erasmus + dhe projekte kërkimore shkencore, edukativo-kulturore etj.
- b. Organizimin e konferencave dhe tryezave të rumbullakta;
- c. Sigurimi i mundësive të praktikës për studentët e të dyja institucioneve në kompani partnere;
- d. Organizimin e aktiviteteve të përbashkëta në fushën e edukimit, kërkimit shkencor, trajnimeve dhe publikimeve;
- e. Shkëmbime eksperiencash përmes mbajtjes së leksioneve të hapura prej të ftuarve nga të dy institucionet;
- f. Njoftimin dhe pjesëmarrjen e stafeve respektive në evente të përbashkëta;
- g. Të tjera mundësi bashkëpunimi në fushën akademike e më gjerë me përfitime për të dyja palët.

NENI 4

Palët bien dakord të respektojnë plotësisht çdo nen dhe të gjitha ligjet që mund të jenë të zbatueshme për shkëmbimin dhe transmetimin e çdo të dhëne, pajisje, informacioni, teknologjie ose personeli në ndjekjen e qëllimeve të përshkruara më sipër.

NENI 5

FINANCIMI

Palët do të hulumtojnë reciprokisht burime të ndryshme institucionale, qeveritare dhe private të financimit për të mbështetur programet që ata parashikojnë. Çdo aktivitet që kërkon burime nga secila palë do të diskutohet bashkërisht për të siguruar që të dy palët të bien dakord për rregullimet financiare para fillimit të këtij aktiviteti.



**KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI**
Prishtinë



NENI 6

Palët bien dakord të mos përdorin emrin ose logon e palës tjetër në evente, programe ose aktivitete të propozuar pa miratimin paraprak me shkrim të palës tjetër.

NENI 7

Kjo është një marrëveshje e plotë midis palëve dhe asnjë përfaqësim, premtim ose marrëveshje tjetër, me gojë ose ndryshe, nuk duhet të mbetet në fuqi ose të sjellë efekte, përveç nëse të dy palët bien dakord me shkrim ndryshe pas datës së kësaj Marrëveshje. Çdo plotësim, ndryshim, rishikim i kësaj Marrëveshje duhet të bëhet vetëm me shkrimin dhe me pëlqimin e ndërsjellë të të dy palëve.

NENI 8

KOMUNIKIMI

Palët do të caktojnë nga një person kontakti që do të jetë përgjegjës për të bashkërenduar aktivitetet e Marrëveshjes, me qëllim që komunikimi dhe shkëmbimi i informacioneve të jetë i shpejtë, konkret dhe i efektshëm.

Për Kolegji, BIZNESI, Prishtinë:

Person Kontakti Atdhe KABASHI,
Adresa: rruga "Myrvete Maksutaj" Nr.1

E-mail: atdhe.kb@gmail.com

[Tel:+38344610878](tel:+38344610878)

Për "Albanian University":

Person Kontakti Prof.Asoc.Dr. Manuela Meçe
Adresa: Bulvd. Zogu i Parë nr.1, Tirana (Albania)
E-mail [m.mece @albanianuniversity.edu.al](mailto:m.mece@albanianuniversity.edu.al)
Mob : +355692027810



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë



NENI 10

HYRJA NË FUQI E MARRËVESHJES

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi me nënshkrimin e saj dhe do të jetë e vlefshme për një afat të pacaktuar. Për të vlerësuar progresin, marrëveshja do të rishikohet gjatë viteve të bashkëpunimit, nëse palët e shohin të arsyeshme.

NENI 11

PËRFUNDIMI PËRPARA KOHE

Kjo marrëveshje mund të përfundojë nga secila palë me njoftim me shkrim të paktën 30 ditë para përfundimit të saj. Aktivitetet në progres në kohën e përfundimit të kësaj marrëveshje do të lejohen të përfundojnë siç është planifikuar nëse nuk është rënë dakord ndryshe.

NENI 12

Palët deklarojnë se është qëllimi i tyre që kjo marrëveshje të veprojë në përputhje me parimet e mirëbesimit, me drejtësi dhe pa dëmton interesat e ndonjëres prej Palëve. Në rast mosmarrëveshesh palët do të përpiqen t'i zgjidhin me mirëkuptim. Nëse Palët nuk arrijnë të zgjidhin mosmarrëveshjet në mënyrë miqësore, atëherë Marrëveshja do të konsiderohet e zgjidhur.

NENI 13

DISPOZITA E FUNDIT

Marrëveshja përgatitet dhe nënshkruhet në 2 (dy) kopje me vlerë të njëjtë juridike.

Palët angazhohen se janë të gatshme të bashkëpunojnë për realizmin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshje.



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë



Kjo marrëveshje Bashkëpunimi u nënshkrua sot, më datë 21.01.2021, dhe hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të saj.

NËNSHKRIMI I PALËVE

Për Kolegjin "Biznesi"
Prof. Dr. Shyqeri Kabashi

(Rektor)

Mr 70 Prof
Dt 21.01.2021

Për Univeritetin

"Albanian University" _____

Prof. Dr. Kaliopi Naska _____

(Rektor)

